



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I QARKUT VLORË

**VENDIM**

Nr. 22, Datë 27/07/2016

**PËR REVOKIMIN E PIKËS 1 TË VENDIMIT TË KËSHILLIT TË QARKUT VLORË NR. 14, DATË 10.05.2016 PËR KALIMIN NË PRONËSI TE PASURIVE TË PALUAJTSHME TË NDËRTUARA DERI MË 10.08.1991, E TË TRUALLIT FUNKSIONAL TË TYRE, KUR NUK POSEDohen AKTE FITIMI PRONËSIE DHE PËR REGJISTRIMIN E TYRE PËR SUBJEKTIN APLIKUES KIÇO MËRTIRI**

Këshilli i Qarkut Vlorë i mbledhur sot më datë 27.07.2016 në zbatim të Ligjit 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të VKM 608, datë 05.09.2012 "Për përcaktimin e procedurës së kalimit të pronësisë të pasurive të paluajtshme, të ndërtuara deri më 10.08.1991 e të truallit funksional të tyre, kur nuk posedohen akte fitimi pronësi, si dhe për regjistrimin e tyre" si dhe të vendimit Nr. 1/1, datë 18.04.2016 të Bashkisë Sarandë.

**VENDOSI :**

1. Të revokojë pikën 1 të Vendimit Nr.14, të Këshillit të Qarkut Vlorë datë 10.05.2016 "Për kalimin në pronësi të pasurisë së paluajtshme të ndërtuar deri më 10.08.1991 dhe truallit funksional të saj" për subjektin aplikues **Z. Kiço Mërtiri** për objektin Banesë vetiake 2 (dy) katëshe me sipërfaqe ndërtimi 130 m<sup>2</sup> kati i parë dhe 130 m<sup>2</sup> kati përdhe dhe sipërfaqe truall funksional 200 m<sup>2</sup>, me vendndodhje në lagjen Nr. 2, rruga "Aleks Verli" të qytetit të Sarandës, zona kadastrale 8641, nr. pasurie 11/362 që kufizohet nga Veriu me pasurinë objekt dykatësh, Jugu me pasurinë nr.11/361, nga Lindja me pasurinë nr. 11/363 dhe nga Perëndimi me pasurinë rruga Aleks Verli.

  
**KRYETARI I KËSHILLIT QARKUT**  
**Sadrit DANAJ**

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë  
Sheshi "4 Heronjtë", Vlorë  
Vlorë (AL)

Web site : [www.qarkuvlore.gov.al](http://www.qarkuvlore.gov.al)  
E-mail: [info@qarkuvlore.gov.al](mailto:info@qarkuvlore.gov.al)  
Tel: +355 33 421 600